Tomor Hysni Selenica datlindja 15-I-1929
Rruga Dajlan Starjis N:o 1 Korçë

Me Lamin të sotshëm
A.A.I'camp capua
Caserta
Italia

I dashuri e nderishmi
Z. Tajar!

Me shëndet jemi mirë, Lus e dëshëroj që të jini mirë, si u dësheron zemra juaj me gjithë familje. Jam i gëzuar shumë që kini ~~fa~~ mbritur shëndoshë e mirë; Më falni që nuk po u shkruaj më gjatë në këtë letër por po u nis një letër tjetër

DUKAGJINI

# Biografi

Që prej moshës 14 vjeç të vitit 1943 kam pasë bërë pjesë
në rininë politike të Ballit Kombëtar.
Në grupet më të para të Qytetit të Korçës kundra siste-
mit Komunist që zvillohejshin në këtë qytet!
Si kryetar të Rinis të ballit komb. të kësaj organizate ishte
Irsan Armata, ish sekretar Skënder Qyteza e antarë të tjerë
të kësaj organizate
Ky grup të rinjësh anti kommunista punoshin pa u lodhur
duke u dreguar çdo të ri? që nuk ishte antar i rinisë e
të mos gaboheshe në drejtime të rena! Kjo organizatë të qe
bërë nga të rinjësh të ballit kombëtar: udhëzohej prej
Kryesis të Ballit kombëtar të qytetit të Korçës.
Traktet që shtypshin për për hapjen e propogandës anti
kommuniste në këtë qytet shtypshin në shtëpinë e të ndje-
rit Qamil Qyteza e në shtëpin e të nderit Irsan
Armata, ku në këto dy qendra që shtypshin çdo i ri.
anti kommunist i shpërndante në për qytetin e Korçës
Me hyrjen e Ballit kombëtar në Korçë, e me organi-
zimin e stabilizimin të Ballit; Rrinia anti Komu-
niste, fillonj edhe kjo të ngrerë shtëpinë e [illegible] rrinisë të
ballit Kombëtar. Duke përfshirë shumë të rrinjësh
në gjirin e saj?
Por me gjithë aktivitetet e rrinisë të Ballit që puno-
nte pa u lodhur e duke u vënë në dieni për çdo të
metë e veprimi kundra komunizmit: Fillonj që kjo
rrini të vinte në dobësi dita-ditës? mbasi propoga-
nta Kommuniste, fillonj që tu pëlqente më tepër.
Për arsye se me propogantën e kommunistavet u
pëlqenin, premtimet e bukura e fantastike. Mbasi
ky popull nuk e kishte provuar parajsën e fanta-

Zuar kommuniste, e se ku do të shpinte kjo rrugë e dja-
llëzuar nga këta dallkauke?

Mbasi komistat me propagantën e tyre të zbukurnar e të për
hapur në të gjithat anën e Shqipnisë; E Mbasi në këtë qytet
të Korçës ishte ay tepër çetat e Rinia e Ballit, sa kjo forçë
luftëtoresh fillon të mbetem një pahile e vogël të
Rrinjësh.

Mbasi kjo forçë e vogël të ~~Rinh~~ rrinjësh e ushtarë të Ballit
kombëtar filloj që të lerë atdheun e tyre: Por para se
të largohej kjo fugi luftëtoresh nga atdheu, po pritur
janë grumbulluar në qytetin e Korçës edhe ballista
të tjerë, prej çamerie, Vlore, gjinokaster të bashkuar
më se 2000 veta, të detyruar që ti thonë vendit të
tyre lamtumirë, më 24 Shtator të vitit 1944, duke u e
dhur në tokat Greke mbasi; ishte e pa mundur që
të bëhej një rezistencë lufte në korrë kundra Ko-
munizmit.

Mbasi kaluam në tokat greke, në Q. e Follorinës për
tu pushuar disa ditë nga lodhja e rrugëtimit.
Kur po pritur në këtë Q. të Follorinës na porogi-
tet disa miq të afermë gjoja miqt? por këto janë
njerzit e organizatës komuniste të (EAMit) të cilët
na kërkoshin që të bashkoshin me komunistat greke
ndër këto njëherës të organizatës komuniste greke ka-
qenë një i njohfur, që quhej Kristo por mbiemirin
nuk po mbaj mend, Por Kristoja njifej mirë me disa
nga Bilishti i Devollit të Korçës mbasi kishte pu-
nuar në Bilisht.

Të gjithë këtë luftëtarë të Ballit Kombëtar Shqi-
ptar që janë të mbledhur në këtë qytet; Kristoja
na bëri një propozim tjetër që të na blinte

DUKAGJINI

armët t'ona: Por Kristan dhe shokët e tij i kishte lënë vëndje ata: që të na blinin armët, prej ushtarëvet të Ballit, mbasi këta ushtarë të Ballit nuk i dorzuan armët asnjë herë kundra komunistavet e kyçushvet moskovitë e jo dine palaçovet grekë të porositur nga komunistat Shqiptarë që të na mashtronin me veprat e tyre dredharake.

Por me gjith mënyrat që përdorën komunistat grekë për të na mashtruar nuk mundën dot, por mundën me një mënyrë tjetër të cilën e përhapën në propagandën e tyre se gjojë ka dalë Zogu në Shkodër?

Por mbas këtyre bisedimevet që u bënë prej organizatës greke Komuniste? na del dhe një tjetër organizatë tjetër greke e cila ishte organizatë Nacionaliste e cila na u lutën që neve të qëndrojmë me forçat nacionaliste greke? e që neve të shkonim ose në Janinë ose në Korfuz, për të luftuar kundra komunistavet grekë e Shqiptarë, Me gjithë se greqija ishte shumë në rrezik prej komunistavet grekë dhe atje ishte shumë e zorshëm qëndrami në ato vënde që na premtuan?

Por me propagandën e përhapur ndër këta ushtarë të Ballit, nga ana e partis Komuniste greke të udhëhequr nga Llustraschimtë komuniste të Shqipërisë, hapën parullën se gjojë ka dalë Zogu në Shkodër, por në realitet nuk gjindej as Zogu as kush veç komunistat.

Mbasi këto força të Ballit kombëtar u detyruan me parullën e elmatisur të Zogut të lënë tokën greke duke hyrë në tokën jugosllave? duke përshkruar Manastirn, Prilepin, Shkupin e në për katundet e këtyre vëndevet shofim, popullin shqiptar të cilët kanë qëndruar shekuj nën turqizimin turk pa i humbur zakonet shqiptare e karakterin i ka shqiptarë: Mbasi përshkimi në këto vënde Shqiptare fillojmë në për zemra të çdo ushtarë të Ballit, të përkujtojmi

me kety ardhje atë popull Shqiptar që prej kohësh nën turqizimin e sot nën disa Serbeë, në ata Shqiptarë që gjetonin e një popull i vogël Serb-e Mal-zezë, të cilët sundonin atë popull Shqiptar nënë robërimin e Serbevet.

Mbas qëndrimit në për ato toka të Shqiptarvet e të Shqipnisë, ç'ne qendrimin e fundit të Shqupit, kaluan këto vënde me plot kujtime të pa harruara.

Hynë në grykat e Kaçanikut e në kosovën e shenjtë Shqiptare e në N/Prefekturën e Ferizojt, kaluam dhe shifnim flamurin Shqiptar kuq e zi që valonte i lirë e në mes të Shqiptarvet Kosovarë e në qetsi të qetë e pa kommunista as Serbë as Kommunista moskovitë të moskes. Prej këti q të vogël të grumbulluar të gjithë ushtoret e Ballit mbritën në qytetin e fundit të Prizrenit Historik, duke i lenë mbrapa shqinës. Kaluam sei në qytetin e Shkodes ~~mbas~~ shumë mundime e vuajtjevet të mëdhaja më datën 20 Nentor 1944 arritem në Shkoder.

Mbasi si mbritem në vëndin t'onë në Shkoder, ç të shofim se nga të gjitha anët e Shqiperisë, e të çdo partije, si Ballistë e zogista e gjindarmë janë mbledhur në qytetin e Shkodrës. Para se neve të mbrinim në Shkoder kishte kaluar i ndjeri Mihtat Frasheri i cili kishte lenë porositur të gjithë ata që janë parë me të ndjerin Mihtat, që çdo ushtar të mos u binte në dorë kommunistavet por të gjindhejnë të pa ~~pa~~ thyeshem kundra kommunistavet.

Po në këtë kohë kur mbeti vetëm e vetmja prefekture pa u robëruar prej kommunizmit, ishte e pa mundur që të bëheshe një rezistencë nga ana e atyre forcavet, me gjith se gjatë kohës që neve në ato rrethe të Kosovës, u fillua e Kosova të tradhëtohet kommunistavet Shqiptarë, e të hynë përsëri Jugosllavët, atë here arritem mbrapa neve dhe disa forca të Ballit Kombëtar

të Kosovës, duke u shumuar e një sasi luftëtaresh Shqiptarë të çdo vëndi e kraine e Kosovarë për bëheshin 25000 veta, por ishte e katë: mbasi demoralizimi kishte filluar në kulmin e vet e me gjith se forcat e tjera që paraashikonin disa kerë Shqiptarë në këtë prefekturë të Shkodrës të luftonin, kondra komunistavet duke pritur në ndihmë edhe 2500 ushtarë Nacionalista jugosllavë që të luftonin kondra komunistavet Shqiptarë jugosllavë.
Por me gjithë këto forca që për bëheshin në këtë vënd për të luftuar kondra të kuqvet qe s po mundur, mbasi disa Shqiptarë nuk e menduan veten e tyre por shikuan që të siguronin ndonjë koltuk më parë mbasandaj; të luftonin kondra të kuqvet, mbasi janë shkaktorët e këtë vëndeti në kohët e fundit Osman Lisufi e Gjon Marka Gjoni mbas i këtyre u ka pelqyer më tepër pozita se sa fati i shumë luftëtarëvet që humbën kot së koti.
Por nuk ishin të Zotet ndo[illegible] ... të kuntoni dredheritë e fundit të komunistavet Shqiptarë. Por u kondisën me anën e disa fletushkavet, e traktevet Kommunista që beshin një thirrje të fundit, që të dorzoheshin në rrjeshtat e të gnajtur Lëvizjë Nacional Çlirimtare Shqiptare, ku ky trakt përmbante këtë thirrje oficera, N/oficera ushtarët të Ballit kombëtar Legalista, komandanta çete: Mbasi inï të falur prej Shtabit të përgjithshem të ushtris N. Çl. Shqiptare, të gjithë ata: Që nuk kanë bërë krime e lyer duart me gjak nuk falen nga popu-lli, por do të lien në mëshirë të popullit, në qoftë se do ti fali populli. Kurse pjesa tjetër që ishte gënjyer prej të kuq-vet ishte e falur, në këtë rast, një pjesë filloj që të lerë përsëri atdheun e tyre e të iki për Itali e me anën e vaporavet, një pjesë tjetër iku nga ana e Jugosllavis për në Gërmani, e një pjesë tjetër u vrat[illegible] malevet të Shqi-përisë e kështu që Shkodra ra më datën 29 Nentor 1944

DUKAGJINI

Forcible mobilizn in LNC of
former Ballists =6=

në dorë të komunistovet.
Pjesa tjetër e këture Nacionalistovet që mbetë në këtë qytet
e pjesët e tjera që ~~mbeten~~ ikën malevet dhe nuk mundën
që të qëndrojnë dot malevet u zunë dhe të gjithë u futën në
në burgjet të këti qyteti.
Si kur e kanë komunistat zakonin e tyre në çdo burg që kishin
bërë në Shkodër, fillaan të bëjnë ndorjet se kush ishte ushtar
e ofiçer nënoficer e komandante çete? të gjithë ushtarët i nxluna
nga burgjet, duke i shëtitur në për qytetin e Shkodrës si rro-
bër lufte e si tradhëtorë të gabuar? e jo se ne nuk ishim
tradhetorë: por atdhetarë, por ishim kundra komunistovet
të kuq e as njëherë tradhëtorë.
Mbas këti rrutullimi në për rrugët e Shkodrës na shpunë
në gazermat e Skënderbeut, mbasi ishim të rrethuar nga
çdo anë nga rojet komunistë të grumbulluar rreth nesh dhe
[illegible] që na rrnonin të gjithë këta atdhetarë,
rë, duke pritur në rrjeshtë të rrjeshtuar: që të vinte ko-
misari që ishte i caktuar për një fjalim: ky komisar nuk
e njofta, por një tjetër që e shoqëronte Sotir Filto nga
Boboshtica e Korçës.
Në fjalimin e komisarit tha: Se të gjithë jeve që i ini
të falur prej popullit, mbasi kini qenë të gabuar nga
ana e tradhëtorve që kanë qenë të shitur ndër fashistat
e Nazistat, prandaj me urdhin e shtabit të përgjithshem
me në krye gjeneral kolonel Enver Hoxha ini të falur por
me qenë se po u fol Shtabi i përgjithshem ju duhet që
të merni pjesë vullnetarisht në rradhët N. Cl. për të
ç'lyer fajet që kini bërë kundra partis komuniste e po-
pullit, mbasi fjalimi ishte ma i gjatë por nuk po e
zgjati me shumë, mbasi fjalët e tyre janë të zakonëshme.
Mbas fjalimit të propozuar me anën e vullnetit të detyruar

DUKAGJINI

u detyruam që të shqetësonim prapa, me anën e rojevet
kommunistë; për në rrugën e Koplikut të Shkodrës.
Në Koplik kemi qëndruar një natë të datës 2 dhjetor 1944 ku në
mëngjes të kësaj dite kanë filluar që të na shpërndajnë në për
brigatat e tyre të divizjonit të VI.të
Mbas shpërndarjes nëpër brigatat e këti divizjoni të gjithë ata
ushtarë të quajtur si tradhëtarë të qenduar. Por vetëm kommunistat
që janë të poshtër e të pa besë, prej këtyre ushtarëvet shofim që të
pushkatohen 9 vetë karshi kommunes të Koplikut të Shkodrës. Mbasi
neve nuk i njifnim dot këta njerës, se nga ishin, mbasi neve ishin
prej tjetër krahine. Kjo sasi patriotësh të mobilizuar gjoja me
vullnet, për bëhej një numur prej 2000 vetash, por dhe numdë që të
ishin e më tepër, prej çdo anë të Shqipërisë.
Me gjithë se u bënë shpërndarjen në për këto brigata: as një nga
këta ushtarë atdhetarë nuk u armatos?
Por me datën 3 XII. 1944 të lodhur e të [illegible] të sotëshur
nga vështirësit e tyre, kaluam kufinin Shqiptar në Hotin e
siperme për në Mal-të-Zi. të gjithë këta ushtarë të këti divizjo[illegible]
ni u shtrinë nga ana e Potgoricës, bazit që në Kolloshinë, për të
luftuar kundra gjermanis Naziste, e një kohësisht gjoja për të
bërë vëllazërimin midis popullit Shqiptar-jugosllav, si mbas
urdhënit të Enver Hoxhës. Por këto nuk ishin qëllimet e vëllazëri[illegible]
mit Shqiptar jugosllav, por nënëshkrimet e Enver Hoxhës e të
Koçi Xoxit? të cilët me anën e këtyre forcave merçenare kom[illegible]
nistë Shqiptare, të okuponin ata Shqiptarë ndodheshin në ter[illegible]
torin e jugosllavisë si Ulqini e Tivari e të tjera vënde që
pushtuan nga forca shqiptare, duke ja u dorzuar vetë Shqiptar[illegible]
këto toka shqiptare? tradhëtorët e shitur te Mladin popov[illegible]
e Dushan Mugoshi. E një kohësisht, për të shdukur Shqiptar[illegible]
të tjerë në këto lufta? e gjithë ata atdhetarë që kishin luftuar
kundra çdo kommunisti, të cilët neve ishim pa armë?

DUKAGJINI

me gjithë se neve ishim të çarmatosur, na futnin në luftë pa armë? Tue na vrarë nga mbrapa Shqiptarë, me tradheti me gjithse ishim pa armë si gratë, e nuk kishin se ngoj të vrushin më parë prej plumbavet të armikut apo nga urdhat që kishin marë komunistat e parshtë, prej Dushanit, Moladinit që zdukni një pjesë Shqiptarë të çdo lloj idollogjije që ndodheshin në për këto brigata të mallkuara.

Mbasi shumë ushtarë nëpër këto brigata ndodheshin pa armë, si shëmbull Kumandanti i Brigatës VI të Jajo gjoliku, na mbajti një fjalim; në katundin Kosor afër Potgoricej, se të gjithë neve ushtarët e rinj që ndodheshim pa armë, të luftonim kundra ushtrisë gjermane me dorë për ti marë armët armikut, se kështu kanë luftuar Partizonët? pa armë ashtu duhet të luftonim edhe neve? Por ishte e pa mundur që tu merej arma ushtarit gjerman? se dhe ata e dinin mirë, por për të na zdukur e për të [illegible] mundu ashtu dhe Partizonët Kommunista për ti mbushur dëshirën armiqvet t'onë shekullorë të jugosllavise.

Mbasi u shtruan këto krahina Shqiptare e u rrobenuan për seri nga Mal-zestë e nuk kishin më nevojë për këtë Divizjon Shqiptar që të rrinte në këtë vend, mbasi ishin të detyruar që të trasferoshin për seri këtë divizjon nga ana e Bosnjës për të shtypur krye gritjet e Bosnjës gjer në Sanxhak? mbasi nga ana e Sanxhakut ndodhej i një divizjon tjetër Shqiptar? që kështu me anën e këtyre dy divizjonet gjo veten që shtypi këto krye gritje të Bosnjës e të Sanxhakut që nuk mundinin dot jugosllavet por me anën e Shqiptarvet? E për tu plotësuar dëshirat e Titos, Meladinit, Dushanit, mbasi këto força i tërhoqën nga Sarajeva e Bosnjë e prej Novi pazarit të Sanxhakut, i rikëthyen për në Kosovën Shqiptare këto força Shqiptare të cilat i përdorinin në vend

Kosovarët e mashtruem nga E. H. Tito's officials



të mosh të mos e zinin zjarrin vetë me duert e tyre: duke
pasur moshë Shqiptarët?
Mbasi nga ana e Mitrovicës në rrethin e Drenicës: ku këtu në
këto vende jugosllavët kishin patur shumë dëme të mëdhaja
prej Shqiptarvet Kosovarë; Por në këto raste që nuk i për ulën dot
jugosllavët, nxorën hynë kommunistat Shqiptarë, që të luftojnë
me Kosovarët? Por Kosovarët kur dëgjonin se po luftojnë me
Shqiptarët, atëhere Kosovarët nuk luftonin kundra kommuni-
stavet; mbasi ata kujtonin se Shqiptarët kanë ardhun të na
çlirojnë nga Serbët, e në këtë mynyrë fillojan Shqiptarët
e Kosovës të gjënjehen e të dorzohen në për brigatat Shqip-
tare? pa ditur e pa kujtuar se çfar po i pret mbrapa
ata Shqiptarë të ngrohtë; që kujtonin të bëhej Shqipëri
Mbasi hynin Shqiptarët mbasi po u dorzonin jugosllavët këto
vende; Sali Bajtimi e Bajazit Boletini, me gjith që u kishte
dhënë tmerrin jugosllavët [illegible] edhe
sot po e kujtojnë jugosllavët, Nuk u bindën ata që të dorzo-
heshin, kundra qëndruan e me Shqiptarët, sa më së fundi
filluan edhe këta të ndjekin e të luftojnë kundra Shqiptarvet
por ishte e kotë se Shqiptarët ja dorzuan Mitrovicën e
Drenicën forcavet Titiste Kommuniste?
Mbasi Hynë jugosllavët Mitrovicë, Prishtinë e nëpër vende
të ndryshme të Kosovës, atë here kanë filluar jugosllavët
të djegin Shtëpi e katunde me radhë të vrasin e të
therin njëherë me thika, si bisha të egra punoshin këto
mizerje jugosllavët. Por këtë nuk e them kot për një gjë të
këtillë, më se njëmijë (1000) vetë janë pushkatuar për një
ditë Mitrovicë, në Ferizaj ku ndodhej një kishë e xhami
më se njëmijë vetë të fjerë janë vrarë në këtë vend, sa
që gjaku ka marë rrugën e Bulevardit Skënderbeut, sa e sa një-
herë të vrarë rrugvet e nga penxheret e shtëpivet.

Për sa unë u shkruaj më sipër, unë i kam parë vetë me sytë e mijë këto gjëra: si dokument tjetër nuk kam mbasi mundëtonja tju cilësonja edhe shumë emra të tjerë, por nuk mund që ti mbaj mënd, se disa shënime që kam pasur më kanë mbetur në Shqipëri.

Unë si një ushtar i mobilizuar në ushtrin e mallkuar të komunistavet, fort nuk kishim të drejtë për mbi këto krime që beheshin kundra vëllezervet Shqiptarë Kosovarë, por i shifnim me sy e me zemër pëlcisnim, jo vetëm që neve ishin ushtarë, por e donjë grادuat, nuk mund që të fliste për këtë të pa drejtë që bejshe, Ai gjofti se fliste mbi këtë të pa drejtë që bënin mbi Shqiptarët e Kosovës? ose do ti pushkatonin ose i dërgonin të arestuar në Shqipëri.

Mbasi divizjoni i VI-e i V të që ishin të për hapur nëpër Kosovën, nga fundi i Muajt Maj 1945 me urdhërin e Koçe [illegible] - nga jugosllavët, e të urdhëruar prej Dushan Mugoshit u transferuan nga ana e Ohrit e Resnjës divizjoni i VI të e nga ana e Dibrës të madhe divizjoni V të për gjatë kufinit Shqiptar: Mbasi e krijem vëllazërim Shqiptar jugosllav. duke lenë Shqiptarët në robëri barbare Serbe, e duke kënaqur Titon e Dushanin në interes të tyre. Si për shpërblim të këtyre veprovet Marshall Titoja, dhuroj të dy divizjonevet një sasi armatimi të lëna nga gjermanët gjatë luftës. Forcat e këtyre dy Divizjonevet u largunen më datën 2 dhjetor të Vitit 1945 duke lenë e gjithë ushtarët; Kosovarë që gjindeshin në për brigatat Shqiptare, duke i lenë për seri në duart e ushtarvet jugosllavë: Por jugosllavët të gjithë ata ushtarë që ishin në për brigata Shqiptare disa i liruan e shkuan nëpër shtëpit e tyre e disa i mbajtën të mobilizuar për në ushtrin jugosllave.

Mbas largimit të divizjonit një pjesë e vogël ushtarë

DUKAGJINI

nuk u tërhoq me divizjon por ka qendruar gjer në
janar të vitit 1946 me materialet që ishin për tu marrë
nga jugosllavia, si jam larguar nga fundi muajt janar të
vitit 1946 prej jugosllavie pak më përbrapa, nga muaj
Mars të vitit 1946 jam liruar prej ushtrie si një moshë
e vogël?
Mbasi jam liruar nga ushtria e shkoj për në shtëpi? por
ishte më mirë të mos vinja? Se familja ime ishte me
ballin e akuzohej si reaksionarë të Ballit, u është marrë
çdo lloj pasunie e lujëshme edhe e pa lujëshme, veten se në
shtëpi qëndronte akoma po u shtetëzuar shtëpia e
një pakicë orendije shtëpie?
Mbasi unë u lirova në 14 Mars të vitit 1946 prej ushtrie me
gjithase ishte e plaçkitun gjithë pasunia, nuk ishte e mjafto
tushme, por më datën X 22 Mars të v. 1946 u arestua dhe ba
baj tim, prej sigurimit të Korçës
Mbasi Babaj ishte arkëtar i Ballit në këtë qytet; e se gjoja
e akuzonin se kishte të fshehura armë në për muret e shtëpi
kurse në realitet nuk gjëndeshin armë që kërkonin në për
muret e shtëpisë, me gjithë se atu i rrëzuan, çdo pjesë
të mureve ku dyshonin e mure të gjithë i ulën për
toke, por më kotë nuk gjetën asnjë gjë më të vogël!
Por veten se ishte arsyeja që të kofinskoshe gjoja me
arsye teshat që gjindeshin në shtëpi dhe shtëpia të
shtetëzoheshin si kurse i shtetëzuan dyqanin edhe
tokat, e një kohënisht për të mbushur, qëllimet e këtyre
spiunavet të poshtër X Bakë Zemuni, Vëdhiraim Bilbili
Neki Zhgaba, Hysen Buzoja, Shimi opari. Se kalzimi i këty
re njëzezurt të poshtër e pa ndërgjegjshmin: Mbas shumë tor
turash që përdorën personalisht mbi babain tim: e më
së fundi dolli në gjyq ku u dënua me vdekje?

DUKAGJINI

me pretendën e prokurorit: por mbasi nuk kishin fakte konkrete? e dënuan me ~~...~~ burg të përjetshëm? Por zoti nuk kishte vendosur që të jetonte me gjithë jetën në burg. babaj im? por me prishjen e reluzicionit të inforburistëvet me jugosllavinë i ulën babës 75 vjet burg. edhe me rastin e benegeshint Koçi Xoxi që u pushkatua në Tiranë i ulën e 25 vjet të tjera. që kishte ~~si~~ mars 22 1951 u lirua nga burgu? Si është lirua babaj prej burgut ishte i torturua aqë shumë, sa nuk kishin lenë gjë pa bërë, rrahje me dru vezë të nxehta, spica në gjithështrintë edhe shumë lloj mundimesh se nuk mund që tjo u për shkruaj. dot me anën shkrimit që po u shkruaj? dot ato tregime që tregonte babaj im? që kishte edhe sot kisaj dite është internuar në për Kongjet, e Fierit e të Kuçit të Vlorës, gjysh prej ~~dot~~ vitit 1946 deri në vitin 1954 në burg. e mbas dy muaj lirie prej burgu gjer më datën e sot në internim Kuç ~~Ko~~ të Vlorës tosh nuk dimë mbi fatin e familjes X?

Në vitin 1949 Mbasi unë punonja në oficinën si auto-mekanik në ndërmarrjen ura Shkozet Durrës.

Në muajin Prill më datën 15 Prill 1949 të kësaj dite: Si kishe fillua punën nga ora 10, më thirri! Shefi i personelit në zyrën e vet, mbasi shefi i personelëvet, kanë e detyrën e sekretarit të organizatavet kommuniste të çdo puntori e N/punsi që për mbante kjo ndërmarje? I gojtuni Sandro Vani nga Katundi Kamenicës të Korçës: Mbasi më thirri në zyrën e vet ay? Sa kohë që kam pasur qëndru në atë ndërmarrje prej 2 vjet, nuk më kishte bërë ndonjë rast që të më thirrte me një thirrje aq të shpejtë.

Sa unë vetën kam kujtuar ose për ndonjë punë, për në o-fiqinë ose ndonjë trasferim.

Por unë sa hyra në zyrën i thashë mirmëngjes, Shoku shef nuk përgjegj me një mënyrë aq të vrazhdet sa nuk më tha mirmëngjes fare, por me një herë me drejtoj me dorë që unë të ulça në një nga karriket, që ishin në atë zyrë të mobiluar, si mbas sistemevet komuniste.

Më tha si shkoni shoku X (Tomor), mirë shoku shef u përgjegja atia? në këtë kohë më tha: se shkoni në zyrën e zëvëndës përgjegjësit me Gago Bojsi nga Korça. Mbasi këto dy zyra kishin të njëjtën lidhje, e një derë i ndodhte që nga mbrenda.

Me një herë u ngrita dhe hyra në atë zyrë, po bëra asnjë zë kur hy! ç'të shof? shofi ~~një~~ një njeri të pa njofur në vëndin e Gagos,

Mbasi hyra mbrenda dhe mbyllo derën e zyrës të Gagos më tha! shoku më parë se ti them unë mirmengjes dhe më pyeti kush ini ju si quheni X Tomor e prej nga jeni? Me çfar punë mereni juve mbasi i tregova se punoj në oficinë? Mbasi ky njeri i pa njofur e pa e parë ndonjë herë unë, filloj të më pyes mua si po kaloni me punë dhe a realizohet plani i shtetit, për ndoj-timin e partis e pushtetit popullor.

Sikur unë të isha ndonjë njeri me përgjegjësi në atë ndërmarje? që unë të dinja se realizohet plani apo jo! Shok unë nuk e di se a realizohet ky plan apo jo? por shoku i pa njofur my përgjegj, ju ini patriot Shqiptar apo jo? unë u përgjegja se duhet t'a dini ju se çfarë punë bëhet në atë oficinë, me qënë se ini vazhdimisht në punë? e shifni se çfarë punë po bëhet aty ku punon ti. Shok u përgjegja unë nuk e di se çfar punë bëhet në oficinën: Si i dëshpruar pak më tha: që ju ini një djalë i mirë dhe e doni partinë komuniste e punoni për pushtetin popullor.

DUKAGJINI

Mbasi unë e shof e dyshoj se se ky njeri më pyet, por unë nuk e njofi dot në të këtilla raste? u detyrova që ta pyes. Por ay my përgjegji, jam një shoku juaj. Unë shok nuk u njofi shok kush ini juve? atëhere my përgjegji se unë jam oficeri i Sigurimit të Durrsit!

Qysh në pyetjet e para kam pasur të dredhura në trupin tim, mbasi nuk isha marë ndonjë herë të këtilla gjëra në jetën t'ime. E si më tha, se jam i sigurimit të Durrsit fillova që të friksohem edhe aq më tepër, sa edhe të zbe-hem në fytyrën t'ime. e të më dien ndërmendt e mija vuajtjet e familjes t'ime, që do të vuante më tepër edhe se babey ishte në burg: edhe unë do të hyenja vetë në burg e do të bëheshin dy vete, pa patur asnjë ndimë familja e unë e baba në burg. njëri pej neve të gjorët.

Mbasi ky njeri që më pa në këtë mynyrë më tha: Kam ardhur që të bisedoj me ju ini një njeri me cilësi të mira, por ju mos u trembni, se neve jemi njëherësh të sigurimit e nuk hamë njëherësh, se edhe unë jam shoku X— Komar) si ju! në këtë kohë më tha një cigare ma nde-zi e tha. më gofsh se ju shoku X.. Komar) më shifni se unë e thyej këtë bishtin e penës që mbante në dorë çfarë do të bëni. Mbasi isha edhe shumë i impresionuar në kulmit prej këti njeriu? Por prapë më kishi një farë kurajo me ni fundi i u përgjegja! nuk është ndonjë punë e madhe, se një bisht pene nuk koston më tepër se 5 Lek e ble çdo puntor edhe evë në vend prej të mos e dëmtuar shtetin.

Por shoku gjeti rastin, se momentalisht na nevojitet? si i bëhet? atë here u përgjegja le ti përgjigjet ay që e thevi e ka kush e kontrollon punën, e jo unë që s'jam kompe-tenti, Por me gjithë ~~ke~~ se unë i jepnja përgjigjen e fjalës të

DUKAGJINI

Interview w. Sigurimi
oficer. offer to work
as a spy.



tij të kundërtën, por ay më pyeste, vazhdimisht, e më tha a do të këtë të këtillë, njëherë në ofiqinë apo jo, unë duke i njofur të gjithë, personat që gjindeshin në atë punë e duke i njofur se cilët, janë kommunistë e kush, janë njëherë që ishin puntorë e jo kundra pushtetit: Por shifnim allin e tyre familjar që të ushqenin familjen e tyre, se skishin ngoj t'ja nbarinin punës të tyre, e jo si mendonte njerin i pa njofur që kam para syve të mija.

unë u përgjegja përseri nuk i njofi puntorët që punojnë me mua, mbasi jam prej tjetër vëndi nga Korça dhe nuk më ka interesuar puna e të tjervet. Por vetëm puna ime dhe aspak për të tjerët, nuk do të më interesojë.

Mbasi më ka bërë dhe shumë pyetje të tjera të cilat nuk i mbaj dhe ndërment, këto fjalë të fëlliqura të tijat, më së fundi më tha se unë të thashë që jam njeri i sigurë-mit? dhe a dëshiron që unë të bashkë punoj me sigurë-mine e pushtetit popullor, edhe çdo punë ose Sabatin, e bise-din që të bëheshe në atë ndërmarje, t'ja raportonja këtë njerin të pa njofur të sigurimit të Durrsit. Duke më marë me të mirë që unë të pranonje, mbasi isha njeri i prekur dhe reaksionar, e se çdo njeri do të kishte mbesim te mua.

Por përgjegjja e ime më e repte ishte jo, e asgjë tjetër nuk mund që të pranoj, mbasi nuk jam i aftë shok për gjëra të këtilla; Prandaj të lutem shumë mos më ngarkoni, një gjë që nuk e bëj dot? dhe për fundi i fundit, veproni si të doni ju vetë, se unë nuk pranoj atë gjë të atillë Spiuna-zhi. Si dëgjoj këto fjalë të egra, atë here më pyeti përseri se ~~kug~~ ku mbanoj unë, e se veta për bëhej familja ime e më tha se neve e dimë që jeni njeri anti pushtet, por shumë shpejt do të bini në dorët t'ona e të popullit.

Në këtë kohë i nevrikosur si unë e më tepër ay u ngri-

DUKAGJINI

tën më këmbë, e unë fillova që të dalnja nga zyra, më tha qëndroni? Mbasi qëndrova edhe u ulja përsëri më tha do të më lëshoni një deklaratë:
Për sa kemi bisedua mua do mos ti tregoni askujt, asnjë pjestari të familjes time. Me gjithë se ky oficer i sigurimit ka dashur që ta bëjë Deklaratën si mbas qefit të vet, por unë nuk e kam pranuar. Deklarata është kjo që vijon më poshtë:

Deklaratë

Deklaroj e vertetoj i nënshkruari Tomor Hysni i lindur më 15-I-1929 me banim në Korçë Rruga Dajlan Starjes N°1 i biri i Hysniut e i Zejnepes.
Për sa kam bisedua sot më datën 15-IV-1949 në orën 10, me një oficer nga të sigurimit, të Durrsit, emrin nuk ja di; shokut që kam bisedua.
Deklaroj me anën e kësaj deklarate, të shkrojtun nga dora ime që të mos i tregoj as prindërvet e gjith pjestarvet të familjes e as kujt tjetër
Në rast se unë do ti tregoj për sa kam bisedua, nxe të nalt për mëndurin, në bazë të ligjit, do të dënohem, me gjyq Special me dyer të mbyllura: me pushkatim, pa një farë përgjegjësinji.
Deklaroj e vertetoj se në rast se tregoj, për sa kam biseduar me oficerin e Sigurimit, do të pushkatohem: si mbas deklaratës time që kam nënshkruar sa vijon:

Deklaruesi
(Tomor Hysni)
Hysni

Shkozet 15-IV-1949

Si mbarova këtë deklaratë: se shkrojturi hyri shefi Komunist edhe tha çfarë bëtë asgjë? Atë herë më thanë mua ikim

DUKAGJINI

në punë se neve e dimë që ju ini kundra pushtetit popullor e partisë do ta shofin këtë punën t'uaj.

I tronditur në kulmit, u largova nga kjo zyrë e mallkuar, e i drejtohem, në dhomën e fjetjes me gjithë se kishte ardhun koha e punës për mbasdite, mbasi në orën 2 pa një çerek, u ndava prej tyre! Mbasi vajta në dhomën e fjetjes, shoku që flinja unë me atë më tha pse nuk ke ngrënë drekë, por unë nuk u përgjigja fare. Por i thoshë që të shkonim në punë, mbasi ora vajti, prej dhome u drejtuam për në punë?

Por ishte e pa mundur që unë të zinja punë me dorë se jam shumë i tronditur. Por ditë ditës kam pritur që të më arestonin, e kur një ditë, pa pritur e pa u kujtuar fare, si kur kishte fillue të largohesha pak mërzitja? Por nga dt. 30 Prill 1949 më arestuan në qytetin e Durrsit duke shetitun i vetmuar gjatë Bulevardit! Më vjen një polic e më thotë: ajdemi pak ju shok se kam punë! por mua më ra ndërmend që do të më arestoje, e i kundërshtova pak, për ishte e kotë mbasi, polici më kërkoj letër njoftimin, e më tha për para se u mblodha e të tjerë njerëz? Këtë arestim kam pritur por nuk kam pasur mundësi mbasi në kufit e grecis ishin të zana nga grekërit, E kështu me fjalët e pakta që bëra polici më çoj në Sigurimin e Durrsit.

Polici më futi në një zyrë të pyetjesvet, për para një oficeri të Sigurimit e më tha: ju ini Xhemal Hysnia, sa shpejt e kini gjetur këtë vënd e tollje të tjera, do të merr mi vesh e dolli nga zyra oficeri. mbas pak kohë ardhi ny oficeri i sigurimit që më kishte marë mua deklaratën në ndërmarjen urra.

Oficeri që më ka marë përsëri në pyetje përsëri, pomë pyet që unë do të dëshmonja jo ose po që të punonja me

DUKAGJINI

se dhembjet e trupit e të duarvet ishin të pa durueshme, me gjith se nuk të mjekonin, por prej mizerjes që ma kishin bërë trupin mua u detyruan që të më bëjnë një farë mjekë-mi por fundi i fundit, prapë asgjë mbasi ndodhësha në birucë, përsëri i vetmuar në ato biruca të tmerrshme e të errësuara pa dritë?

Mbas një për mirësimi prej torturavet që hoqa në sigurim më lëshuan me kondita që unë të mos u tregonja askujt e duke mbajtur një deklaratë të dytë të cilën vetëm se e nën shkrova? po ç'far për mbante ajo deklaratë nuk di-farë mbiatë. e kështu më datën 15 VI 1949 qershor më lëshuan që unë të drejtosha në punën ku isha mbasi, të mos i tre-gonja asnjë njeriu, por gjoja sikur kam qenë në spita-lin civil në Tiranë.

Mbasi dolla nga burgu Sandri Vani me drejtorin e ndër-marjes më thirri, në drejtori, e se gjoja ata nuk dinin se ku kam qenë, por unë u thashë që isha në spitalin që më dërguat ju, por drejtori e shefi u panë në sy, me njëri tjetrin, duke qeshur, mbasi u dukej katilavet se bënë punë madhështore; e me sa se kundi, si bënë 14 ditë i li-rë, më 29 VI-1949 më vjen shkresa prej drejtoris e zyrës të personelit që nga data 30 VI-1949 të jem i liguiduar prej ndërmarrjes uvra, si neglizhus i punës e i pa disiplinuar karshi punës shtetnore, që me atë dokume-nt të mos kapnja punë në asnjë vend në shqipëri? — Kështu më datën 30 qershor u detyrova të kthehem pranë familjes time në Korçë?..

Por komunistat nuk janë të kënaqur me gjakun që kanë pirë; dhe punë kundra çdo elementi! që nuk i do e si kurë ti dnash, prapë së prapi; ata u duket sikur nuk i do dhe vehvetja e tyre, me dashje pa dashje

regjimi komunist i bën që njerëzit me të thirheshtë e pu-
ntorë që të bëhen kundra regjimit të kuq-komunist, e të
braktisin familjet, e të detyruar të lenë atdheun e
tyre e të shkojnë në vatrat e të huajvet, ku jetojnë të
ndarë nga familjet e atdheu i tyre?
Në vitin 1949 në muajin korrik mbasi jam i pushuar, nga puna
e si jetosha në Korçë pranë familjes time e gjindesha, pa punë
e pa triska buke e ushqimi: çdo puntor që ka qënë i pushuar nga
puna ose me artizanate prihvate e të tjerë, nuk kanë pasur
të drejtë më triskitimi. Ishin të detyruar që të blinin në
tregun e zi shtetnor çdo gjë me të shtrenjtë:
Si shëmbull, që çdo njeri pa triskë buke nuk mund që të rrojë
por në shtetin komunisht të lehtësuar gjoja, për njerëzit që
pushoshe si puntor ose Nëpunës e të tjerë ishin të detyruar që të bli-
nin në për gjyganet e furrat e shtetit. 1 kg. bukë misri të
hidhur koshtonte 65 Lek 1 kg. Duke pritur në furrën e shtetit
që të zinje radhë prej orës 5 të mbas-ditës e gji në orën 5 të
ditës të nesërme, e kështu që çdo njeri që priste në atë furrë i
duheshe që të rrinte 24 orë pa lojtur nga vëndi; e se në
rast se largoheshe, ishte e pa mundur që të merrje, bukë
të misrit të hidhur si Ehm:
Mbasi kjo furrë ndodhej e fshehur sa të mos e shikonte e
hoti vetë e jo njerëzit e huaj të mos e shifnin. Por këto
furra nuk ndodheshin vetëm në Korçë por në çdo Prefek-
turë të Shqipërisë të cilat gjoja quheshin furra speciale
shtetnore, por në të vërtetë furrat e vdekjes: e kështu
quheshin e nga populli vetë: furra e vdekjes:
Si kur çdo puntor, Nëpunës e të tjerë që janë të pushuar
nga puna, duhej që të paraqitej në këshillin e Sektorit
të banonte në qytet ose prej katundi duhej të kishte një
vërtetim prej katundi që të merrnin në furrën e vdekjes

DUKAGJINI

se me vetetimin e këshillavet që leshoheshin ose me listat
që jepte këshillat mund që të merrje bukë?
E këto lista i paraqiteshin përgjegjësit të furrës, një farë
Petro Thomajt me banim në Korçë, i cili ishte i lidhur
Me sigurimin e qytetit, por me një shpirt shumë të
keq sa që nuk i për sharrnat pa shpirtësia e tija se
si sillej kundrejt popullit.
Por Petro Thomaj sa afroshin njëherzit afër derës të fu-
rrës shumë veta i kthente e nuk i u jepte bukë, me
gjith se kishte persona 24 orë që priste në atë furrë të ma-
llkuar, me gjithë se këtë gjë Petro Thomaj e bënte më
të për për njëherzit të prekur kundër pushtetit, e
një kohësisht personi që ishte tue pritur me natë e
ditë të detyrohej që të priste përsëri e 24 orë të tjera
mbasi nuk kishte se ç'farë të bënte, në shtëpi në rost
se do të kthehshe, mbasi femijë i lipnin bukë, e vetë
nuk mund të lonte dot, nga vendi nga mos nyrenjë.
Veç kësaj që nuk të merrje dot, por ishte edhe shumë
vështirë mbasi rreth kësaj Furre mbidheshin më tepër
800 veta, se me shpresë se do të merrin bukë, kurse
në realitet nuk merrnin dot as një 100 veta mbasi edhe
nuk bënin bukë sa të furnizonin të gjithë këto
njëherës që gjindeshin pa triska. ishte edhe shumë vështirë
se deri një një farë vendi vazhdoshe një rregjisht, por
për pak minuta, prishej rregjishti, e populli fillonte
të shtyhej e të vriteshin, midis të shtypes, se në
vitin 1949 janë vrarë 3 gra e 1 plak, por për fat nuk
më kujtohen emrat e tyre, e nga ana tjetër të rrahte
e spiunat e sigurimit, që të mos flisnje as të mos bënje
diçka tjetër, Në këtë mynyrë ka vazhduar kjo furrë gjer
në vitin 1951 edhe mbas ikjes time

DUKAGJINI

e si kana posur qenë përsëri thuhej se vazdon akoma e kësaj dite, që kjo furrë vdekje. Kjo është liria e popullit prej regjimit të kuq të Enverit e liraje e këti populli fatkeq.

Në regjimin e kuq të Enverit e të Mehmet Shehut; që ta thonë shtrojnë mirë puntorët e fshatarët e N/punsat e popullit Shqiptar.

Marim si shëmbull një puntor me kazmë të thjeshtë të Kategoris të parë merr Lek 86 e puntori i klasit të II-të merr lek 72. por në rast se ky puntor mbush normën e caktuar prej 4 metro kub dhé që të gërmoje ose të qërojë në vendin e caktuar, në rast se puntori i klasit të parë e ka mbushur normën mund që të marë, për veç ditëvet të diela që nuk punon, për çdo 15 ditë Kl. I-rë 1118 Lek, e në qoftë se nuk e mbush nuk ka si ti marë këto Lek që kështu puntore mbrin deri 800 Lek deri në 900 Lek, por shumë të rrallë janë puntorët që i mbushin normën e të marin të plotë rrogën e caktuar, mbasi urtësia e pa mos pasur ushqimin në regull nuk mund që të realizojë normën e caktuar, se buka është 800 gram misër ose gruri, e gjella që i bëhet është një fare. ashtu dhe puntori i klasit të dytë nuk mund që të marë për çdo pesëmbëdhjetë ditë më tepër se 926 Lek. e kështu që dhe bukën e gjellën që paguajnë për çdo ~~po~~ 15 ditësh u kushton 500 Lek gjer në 600 Lek e sa i mbetën atij në shtëpi e për familjen nuk i dalin, po ti lemë për nevojat e tjera? —— -

Ndonjë puntor ose nëpunës që do të bëjë ndonjë farë ekonomije, që të teproje ndonjë Lek, për familjen ose për diçka tjetër, detyrohet që të hajë bukë e kripë, për të mbushun ndonjë nevojë familjare ose vetjake.

Çdo N/punës që merrë rrogë mujore të kategoris mesatare

DUKAGJINI

merte për një muaj 2400 Lek deri 2500 Lek, ose ndonjë nëpunës me përgjegjësi të madhe, mund që të kishte një rrogë bazë mat të mirën gjer më 5000 Lek.

Sa për puntorët Specialistat të ndryshëm dhe këto nuk kanë një shpërblim në punën e tyre si duhet, se një automekanik i klasit të parë nuk mund që të merte më tepër 20 Lek në një orë, në ditën 160 Lek e një auto mekanik i Specializuar të klasit të parë mer në orë 24 gjer 25 Lek, në ditët 192 gjer 200 Lek, këto rroga kanë puntor e thieshtë e të nëpunsat e profesionistat e ndryshme në rregjimin e Kuq.

Çdo puntor ose N/punës për fitonte këto triska: triskë buke ushqimi, Vesh-mbathje. puntori për fiton nga triskat e pa ësura:

| | |
|---|---|
| Bukë misri ose gruri | 800 gr. |
| Vaj Lule djelli | 700 " |
| Sheqer | 500 " |
| Makarona | 800 " |
| Kripë | 500 " |
| Marmallatë | 500 " |
| Oriz | 500 " |
| Sapun | 400 " |
| Vezë | 2 copë |

Mbasi në triskë për banin shumë artikuj të tjerë, por kur kishte i jepnin dhe shumë, nga këto artikuj që për mbante triska nuk i jepnin fare dhe kështu, kur kalonte muaj i humte afati, e nuk kishe më të drejtë që ti për fitonje artikujt që mbante triska.

Prej triskës të Vesh-mbathjes që për ~~ba~~ mban 200 pika: Mund që të marrë, 3 metra stofë të çfar do kualite, në rast se mer 3 metra stof me këtë triskë e një palë këpucë ose opinga Lastiku, se kishte ti presin të gjitha pikat e nuk për fiton asgjë tjetër.

DUKAGJINI

se në trishkën e Vesh-mbathjes, për mbajën shumë artikuj
industriale por nuk i mer: mbasi janë të shënuara por
me pakicë shumë të vogël, e kështu, kur mer 3 metra stofë
nuk përfiton asgjë tjetër si mbas artikullit, që shënohen
në trishkë. Sa për nënpunsat e triskat ordinere, kanë shumë
më pak se sa të puntorvet.
Vetëm në Shqipëri mund që rrojnë ata puntorë ose më
mirë të themi rrojnë të gjithë ata që janë antorë partie
ose Spiunë në për Ente shtetnore të ndeimosjevet, se në
për ndeimosje, janë të caktuar persat që quhen gjoja pun-
ntorë ose puntorë të kualifikuar të cilët marin nga një
rrogë 10000 gjer më 12000 Lek në muaj, dhe të pajisura me
triska suplimentare. Se sa për shtresat e ndryshme Varf-
në jashtë zakonisht, nga çdo pikpamje ekonomike eshtë dhe
politike.
Mbasi sot në regjimin e Kuq të Enver Hoxhës të shitur
ndër moskovitet e moskës, gjithmonë e trombetojnë, me anë
e Koferencave që bëhen në qytete e katundet: Se ata e dinë
mirë se sa rron ky popull, se gjithmonë ata e kanë
barkun e gohpur e nuk kujtonë për popullin që rron
por fajtorë na del në popull, Kullaket, mikro burgjezit
reaksionaret, imperialistat anglo amerikanë, se këta janë
fajtoret e ekonomis të ~~gje~~ Shqipëris; megjithë se fjalimet
e tyre të pa farë ndeilidhura: nuk mund që të bëhet as
një farë diskutimi, por si të thonë të diguarit ashtu
do të thosh? Kjo është Liria e ~~de~~mokracia e tyre që thë-
resin në çdo vend, duke u munduar ati popull sot të
kejë për interesat e tyre?,
Nuk është nevojë që të zgjatem më tepër përgjara
të këtilla mbasi në për emisionet t'uaj i ja u kini
dhënë më mirë se sa pro ja u dirgoj unë.

Tomor Selenica

DUKAGJINI

H.A.Peters
Engl.Garten 1
Munich

(13b) MÜNCHEN 22
21.6.56

RFE

TOMOR

Tomor Selanica

~~Head of the B.B.C.~~
East European Service
Bush House
LONDON WC 2

LUFTPOST

LUFTPOST

AIR MAIL

23 JUN 1956

Tomor

DUKAGJINI